

## DEKLARATË PËR SHTYP

### **Organizatat e Shoqërisë Civile Mjedisore bojkotojnë proceset konsultuese të Ministrisë së Mjedisit deri në shfuqizimin e ndryshimeve në Ligjin për Zonat e Mbrojtura**

Tiranë, 12 qershor 2026

Organizatat e Shoqërisë Civile mjedisore shprehin qëndrimin e tyre të qartë se nuk mund të marrin pjesë në proceset konsultuese të organizuara nga Ministria e Mjedisit për sa kohë që mbetet në fuqi Ligji nr. 21/2024 për ndryshimin e Ligjit për Zonat e Mbrojtura, i cili ka hapur rrugën për zhvillime dhe ndërhyrje në territore që duhet të gëzojnë nivelin më të lartë të mbrojtjes mjedisore në vend.

Në këtë kuadër, organizatat mjedisore kanë refuzuar të legjitimojnë tryezën e konsultimit publik të projekt-akteve, të thirrur nga Ministria më 12 qershor, duke e bojkotuar dhe duke mos dhënë komente teknike, me qëllim që të mos bëhen pjesë e një procesi që synon të paraqesë një normalitet institucional që nuk ekziston. Ndërkohë që diskutohet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian, në terren po avancojnë projekte të mëdha infrastrukturore dhe turistike brenda rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura, duke cenuar rëndë integritetin e këtyre ekosistemeve dhe duke vënë në pikëpyetje serioze angazhimin real të institucioneve ndaj standardeve evropiane të mbrojtjes së natyrës.

Ky qëndrim mbështetet edhe në reagimet dhe deklaratat e përbashkëta të organizatave mjedisore të publikuara<sup>1 2 3</sup>, të cilat kanë kundërshtuar në mënyrë të vazhdueshme ndërhyrjet në zonat e mbrojtura dhe ndryshimet ligjore që cenojnë integritetin e tyre.

Organizatat e Shoqërisë Civile e konsiderojnë **shfuqizimin e ndryshimeve të miratuara me Ligjin nr. 21/2024 si edhe anulimin/moslejimin e projektit të ndërtimit të resorteve turistike në Zonën e Mbrojtur "Pishë Poro-Nartë" si një kusht të panegociueshëm dhe paraprak për çdo dialog të mëtejshëm institucional mbi çështjet e mjedisit dhe procesin e integritetit evropian**. Kjo kërkesë nuk përfaqëson vetëm një shqetësim të organizatave mjedisore, por është reflektuar qartë edhe në piketat përmyllëse (closing benchmarks) të Komisionit Evropian për kapitullin 27 të negociatave, të cilat kërkojnë garantimin e mbrojtjes efektive të zonave të mbrojtura dhe përafrimin e plotë me standardet evropiane të ruajtjes së biodiversitetit.

Për këtë arsye, Organizatat e Shoqërisë Civile nuk e konsiderojnë relevante pjesëmarrjen në konsultime teknike për akte të reja ligjore dhe nënligjore, për sa kohë që çështja më themelore e mbrojtjes së zonave të mbrojtura mbetet e pazgjidhur. Përpjekjet për të demonstruar progres në procesin e integritetit nuk mund të jenë të besueshme kur problematika më serioze identifikuar në fushën e mjedisit vazhdon të mbetet e hapur.

Ky qëndrim merr një rëndësi të veçantë në një moment kur qytetarët, aktivistët dhe komunitetet lokale në mbarë vendin kanë protestuar për **12 ditë me radhë**, duke kundërshtuar cenimin e zonave të mbrojtura dhe duke kërkuar mbrojtjen e trashëgimisë natyrore të Shqipërisë.

---

<sup>1</sup> [Deklaratë e përbashkët për shtyp e OJF-ve mjedisore](#)

<sup>2</sup> [Deklaratë e Përbashkët e Rrjetit GreenAL mbi ndërhyrjet në Zonën e Mbrojtur Pishë Poro-Nartë](#)

<sup>3</sup> [Kërkesë për rishikimin e politikave të qeverisë shqiptare për Zonat e Mbrojtura](#)

Organizatat e Shoqërisë Civile mjedisore deklarojnë se ky bojkot nuk është një veprim simbolik i izoluar, por një qëndrim parimor që do të vijojë të mbetet i pandryshuar edhe për çdo proces të ardhshëm konsultues të thirrur nga institucionet përgjegjëse, deri në adresimin e kësaj çështjeje themelore. Nuk mund të ketë konsultim kuptimplotë, dialog të sinqertë apo progres të besueshëm në procesin e integritimit evropian, për sa kohë që kërkesa për shfuqizimin e Ligjit nr. 21/2024 mbetet e paplotësuar.

**Mbrojtja e zonave të mbrojtura nuk është një çështje procedurale. Ajo është një provë e vullnetit të shtetit shqiptar për të respektuar Kushtetutën, interesin publik dhe detyrimet e tij ndaj Bashkimit Evropian.**

## **Lista e organizatave të shoqërisë civile që mbështesin bojkotin e dëgjësave publike**

*(Në rend alfabetik)*

AlbNatyra Association

CELIM Shqipëri

CoPlan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

EcoAlbania

GARD - Grupi i Aktivisteve Rurale te Dibres

LUMI

Përtej të Sotmes

Pseda-ILIRIA

Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Albania)

Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)

Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

Qendra per Transparencë dhe Informim të Lirë

Rrjeti per Raportimin e K.O.K.Sh

SEEP

Shtëpia e Gjelbër

Shoqata "Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz

Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)

VIS Albania